

Vendim nr. 113 datë 29.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Sandër Beci, Anëtar
Marjana Semini, Anëtare

në datën 29.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (F) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FIQIRI BEZATI,**
DRITA BEZATI,
NAJADA BEZATI

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-3608 (521), datë 07.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2810, datë 25.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 42, 117, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesit janë familjarët e dy shtetasve, të cilët, si pasojë e një aksidenti automobilistik, në datën 19.10.2010, kanë humbur jetën. Në lidhje me këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pushimin e procedimit penal ndaj

drejtuesit të automjetit. Ndërkohë, ka rezultuar se automjeti shkaktues i dëmit ka qenë i siguruar me policë sigurimi pranë shoqërisë së sigurimeve ish-“Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., sot “SIGMA Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a. (*shoqëria e sigurimit*).

2. Mbi bazën e kërkesës së kërkuësve, shoqëria e sigurimit i ka dëmshpërblyer ata në masën 3,443,416 lekë dhe 3,712,000 lekë. Vlera e dëmit është përlllogaritur në bazë të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar (*ligji nr. 10076/2009*). Duke mos qenë dakord me masën e dëmshpërblimit, kërkuësit i janë drejtuar gjykatës me padi në datën 12.07.2012.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12844, datë 23.12.2013, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit t’u paguajë kërkuësve së bashku shumën prej 23,577,394 lekësh, si dëmshpërblim i plotë i dëmit pasuror dhe jopasuror nga aksidenti i shkaktuar, bazuar në ligjin nr. 10076/2009, Kodin Civil dhe vendimin unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 (*vendimi unifikues nr. 12/2007*), si dhe kamatëvonesat ligjore të kësaj shume, sipas interesave të bankave të nivelit të dytë, nga dita e ngritjes së padisë, më 13.07.2012 deri ditën e ekzekutimit të vendimit. Gjykata ka arsyetuar se ngjarja ka ndodhur në datën 19.10.2010 dhe për llogaritjen e dëmit, referuar kohës kur ka ndodhur ngjarja, nuk mund të zbatohet rregullorja nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar (*rregullorja nr. 53/2009*), e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), pasi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, dhjetor 2011, për rrjedhojë nuk ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjes.

4. Mbi bazën e ankimit të shoqërisë së sigurimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2810, datë 25.06.2014, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur detyrimin e shoqërisë që t’u paguajë kërkuësve shumën prej 848,051 lekësh, si diferencë e papaguar e dëmit pasuror dhe jopasuror, si dhe interesat për këtë shumë referuar interesave të aplikuara nga bankat e nivelit të dytë, nga dita e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim e deri në ditën e ekzekutimit të vendimit. Kjo gjykatë ka arsyetuar se rregullorja nr. 53/2009 ka hyrë në fuqi pasi është publikuar në faqen zyrtare të internetit të AMF-së dhe rasti në fjalë ka qenë në proces trajtimi nga shoqëria e paditur. Mospranimi i faktit se akti nuk ka qenë në fuqi, do të thotë moszbatim për një periudhë dyvjeçare të ligjit nr. 10076/2009. Sipas saj, vlera e dëmit duhet të llogaritet duke marrë për bazë ligjin nr. 10076/2009, për sa u përket parimeve dhe kufizimeve, si dhe rregulloren nr. 53/2009 të AMF-së, për sa i përket metodologjisë dhe kriterëve që duhen marrë parasysh në çdo rast për vlerësimin e dëmit. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuësit.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin e datës 30.09.2016, ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes civile në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Ky vendim është revokuar në datën 19.04.2022 dhe rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit në datën 07.12.2022. Në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3608 (521), datë 07.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjen zbatim rregullorja nr. 53/2009, e cila ka qenë në fuqi në kohën e regjistrimit të padisë (datë 12.07.2012), duke qenë se ajo ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në atë kohë (dhjetor 2011).

6. Në datën 29.03.2023 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2022-3608 (521), datë 07.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. 2810, datë 25.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuessve

7. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmblëdhur, kanë pretenduar se gjykatat i kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor* në aspekt të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë dhe gjykata e apelit kanë dhënë vendime të mbështetura në dispozitat e një akti që nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja, duke i dhënë në këtë mënyrë fuqi prapavepruese aktit. Për shkak të aplikimit të normave që nuk kanë qenë në fuqi, argumentet e pjesës arsyetuese të Gjykatës së Lartë kanë krijuar paqartësi, ato janë të pabazuara dhe të palidhura logjikisht.

7.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi shpërblimi i dëmit është trajtuar mbi bazën e akteve normative që nuk kanë qenë në fuqi dhe në këtë mënyrë ato e kanë përkeqësuar në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të subjekteve, duke u mohuar të drejtat dhe interesat e tyre.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuessve*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkesit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e trashëgimtarëve të viktimave nga aksidenti, kanë vënë në lëvizje procesin gjyqësor për përfitimin e dëmshpërblimit, për të cilin kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë ata provojnë interesin e tyre në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se kërkesit i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, ku nëpërmjet këtij të fundit është përmbyllur në themel procesi gjyqësor i iniciuar prej tyre, për rrjedhojë ata i kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohen Gjykatës.

13. Në vijim, Kolegji çmon se kërkesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i fundit i kundërshtuar është dhënë në datën 07.12.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 22.03.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspekt të parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës, të garantuara respektivisht nga nenet 42 dhe 41 të Kushtetutës.

15. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, kërkuesit kanë parashtruar se gjykatat e kanë trajtuar shpërblimin e dëmit mbi bazën e akteve që nuk kanë qenë në fuqi në kohën e ngjarjes, duke përkeqësuar gjendjen e tyre në mënyrë të paarsyeshme, duke sjellë, për pasojë, edhe cenimin e pritshmërive të ligjshme. Në kontekst të këtyre argumenteve, Kolegji, vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i ndërruar nga ai për cenimin e procesit të rregullt ligjor, për rrjedhojë çmon ta analizojë atë në këndvështrim të këtij të fundit në aspektin e sigurisë juridike, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate.

16. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkuesit kanë parashtruar se gjykatat kanë konsideruar se efekti i zbatimit të normës juridike është i lidhur me datën kur palët kanë kërkuar në gjykatë zgjidhjen e konfliktit dhe jo me momentin e ndodhjes së ngjarjes dhe pikërisht për këtë detyrimi duhej të llogaritej sipas akteve të kohës. Sipas tyre, akti që i janë referuar gjykatat në vendimet e kundërshtuara, mbështetur në nenin 117 të Kushtetutës, i fillon efektet pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të AMF-së nuk mund të konsiderohet si momenti i hyrjes në fuqi. Po kështu, ata kanë argumentuar se çështja kryesore e shtruar për zgjidhje përpara Gjykatës së Lartë dhe që përbën thelbin e mosmarrëveshjes lidhej me faktin se cila dispozitë duhej të zbatohet për dhënien e dëmshpërblimit. Vendimmarrjet e kundërshtuara kanë cenuar drejtpërdrejt parimin e pritshmërive të ligjshme, interesat legjitime dhe të drejtat e fituara, pasi janë bazuar në norma që nuk kanë qenë në fuqi në kohën e lindjes së këtyre të drejtave. Argumentet e Gjykatës së Lartë janë të paqarta, të pabazuara dhe të palidhura logjikisht.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në të cilin Gjykata ka pohuar se zbatohet parimi i sigurisë juridike. Sipas saj, ky parim, nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 11, datë 21.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ai është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh

prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke vlerësuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesit, në thelb, kanë kundërshtuar mënyrën (metodologjinë) e përlllogaritjes së shpërblimit të dëmit nga shoqëria e sigurimit. Ndërkohë ka rezultuar se gjatë gjykimit në shkallë të parë, gjykata ka caktuar një ekspert, i cili, në nxjerrjen e vlerës financiare, është bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe vendimin unifikues nr. 12/2007 të Gjykatës së Lartë. Ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në momentin e ndodhjes së aksidentit (19.10.2010) ka qenë në fuqi ligji nr. 10076/2009, ndërsa rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së është publikuar në Fletoren Zyrtare (31.12.2011) pas kësaj date, për rrjedhojë ajo nuk mund të zbatohet. Ky vlerësim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit të Tiranës, e cila në të kundërt, ka arsyetuar se dëmshpërblimi duhej të llogaritej bazuar në rregulloren nr. 53/2009, e cila ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit, pasi ka qenë e publikuar në faqen zyrtare të AMF-së (25.06.2009), në përputhje edhe me përcaktimin në nenin 51, pika 3, të saj. Me të njëjtën qasje mbi metodologjinë që gjen zbatim në rastin konkret ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, por zbatimin e rregullores e ka lidhur me datën e regjistrimit të padisë (12.07.2012), pra sipas saj kërkuesit kanë ngritur padi pas botimit të rregullores në Fletoren Zyrtare.

20. Gjithashtu, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë ka zgjidhur në themel rekursin, duke analizuar vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim referuar fakteve të rastit në shqyrtim. Vendimi i saj paraqitet i rregullt në formë dhe pasqyron në mënyrë të plotë dhe të detajuar jo vetëm rrethanat, por edhe vlerësimin ligjor, duke vepruar në përputhje me rolin dhe funksionin e saj kushtetues të përcaktuar në nenin 141 të Kushtetutës. Në këtë pikë, Kolegji rithekson se vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara gjatë procesit gjyqësor, si dhe interpretimi i ligjit për qëllim të këtij procesi janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që

të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk ndodhen në kushtet e ndonjë të drejte të fituar nga ligji ose nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë, e cila të jetë vënë në dyshim nga vendimet e kundërshtuara. Çështja e pritshmërive dhe interesave të ligjshëm, si dhe të të drejtave të fituara, në rastin në shqyrtim, lidhet me vlerësimin e provave dhe interpretimin e zbatimin e ligjit, gjë e cila rezulton të jetë përmbushur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Po kështu, nuk rezulton që ato ta kenë zbatuar ligjin në mënyrë arbitrare. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është haptazi i pabazuar. Në këtë situatë, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës, i cili bazohet mbi pritshmëritë e ligjshme dhe të drejtat e fituara, është haptazi i pabazuar.

22. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.